

VENDIM
Nr. 262, datë 19.12.2018

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 188, DATË 10.11.2017, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar; nenit 3, pika 50; nenit 22, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 4, pika 1, gjerat “a” dhe “b”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017 ka vendosur “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 20.8.2018.

- Me shkresën nr. 495/1 prot., datë 23.8.2018, ERE ka përcjellë pranë “Albgaz” sh.a. njoftimin e vendimit nr. 178, datë 20.8.2018, të sipërcituar, duke i bërë me dije edhe detyrimin për depozitimin e dokumentacionit të munguar brenda datës 20.12.2018.

- Sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 88/1 prot., datë 14.12.2018 (protokolluar në ERE me nr. 495/3, datë 17.12.2018), me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 4.3.2019 duke informuar ERE-n mbi përditësimin e procedurave të dokumentacionit për pajisjen me certifikatën e pronësisë për: Sheq i Madh, Fier Drizë, Fier Gjonçe, Lavdan.

- Për pasuritë Cërrik, Drenovë, Mallakastër Balldren, Mallakastër, “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka bërë kërkesë në ZVRPP-në përkatëse, në kuadër të mundësisht të ecjes me ritme të shpejta në procesin e regjistrimit të aseteve.

- Me qëllim plotësimin e dokumentacionit shoqëria “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes Mjedisore të (tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.

- “Albgaz” sh.a. duke risjellë në vëmendje edhe ndryshimet në drejtimin e shoqërisë si dhe strukturave të ministrive nga të cilat ka varësi, bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara nga vendimet e sipërcituara.

- “Albgaz” sh.a. kërkon nga ERE shtyrjen e afateve të dërgimit të dokumentacionit të munguar të vendimeve sipërcituar, mundësisht deri në datën 4.3.2019.

- Çështjet e parashtruara për të cilat kërkohet shtyrja e afateve të paraqitjes është jashtë vullnetit të “Albgaz” sh.a. për realizimin e tyre në kohë, pasi janë kompetencë e institucioneve të tjera përgjegjëse. Duke qenë të tilla duhet të reflektohen ndryshimet e kërkuara nga “Albgaz” sh.a., në afatet e vendosura në vendimin për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë ‘Albgaz’ sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

“Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 4.3.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar...”

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti